



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
REKTORI

Nr. 2152 Prot.

Tiranë, më 02.12.2025

URDHËR

Nr. 146, Datë 02/12/2025

PËR
ZHVILLIMIN E ANALIZËS VJETORE TË PUNËS
PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025 NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në zbatim të nenit 32, nenit 38, pika 1, germa "g", nenit 39, pika 12, nenit 49, pika 1, germa "h" të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, "Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", të ndryshuar, të Ministrit të Sportit dhe Arsimit, Udhëzuesit "Për modelin e raportimit vjetor të IAL, në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, të Ministrit të Sportit dhe Arsimit" të AKFAL, pranë MAS, si dhe nenit 24, *Funksionet e Senatit Akademik të UART*, neni 27, *Funksionet e Rektorit*, nenit 29 *Rektorati*, nenit 30 *Komisionet e Përhershme*, neni 48 *Funksionet e Bordit të Administrimit*, neni 147 *Raportimi të Statutit të Universitetit të Arteve*, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Njësitë kryesore, njësitë bazë, drejtoritë, degët/sectorët në Universitetin e Arteve, të përgatisin dhe të zhvillojnë analizën vjetore të punës, për vitin akademik 2024-2025, **brenda datës 12.12.2025.**
2. Fakultetet e Universitetit të Arteve, materialin e analizës vjetore **mbi veprimtarinë akademike**, ta dorëzojnë në zyrën e protokollit **brenda datës 12.12.2025**, dhe në formë elektronike në adresën e emailit: zvrektorimesimor@uart.edu.al.
3. Drejtoritë, degët/sectorët në Universitetin e Arteve, materialin e analizës vjetore të punës, **për veprimtarinë administrative** ta dorëzojnë në zyrën e protokollit, **brenda datës 12.12.2025** dhe në formë elektronike në adresën e emailit: zvrektorimesimor@uart.edu.al.

4. Materialet, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij urdhri, mbliidhen në një dokument të vetëm nga Zëvendësrektori për Anën Mësimore.
5. Analiza vjetore e njësive kryesore, njësive bazë, drejtorive, degëve/sectorëve në Universitetin e Arteve, të përqendrohet në realizimin e objektivave të planifikuara për vitin akademik 2024-2025, **sipas funksioneve të tyre**. Secili prej elementëve të raportimit sugjerohet të plotësohet në mënyrë narrative, tabelare ose me grafik, sipas Udhëzuesit “Për modelin e raportimit vjetor të IAL, në zbatim të udhëzimit nr. 5, datë 19.02.2018, të Ministrisë së Sportit dhe Arsimit” të AKFAL, pranë Ministrisë së Arsimit.
6. Për përgatitjen e Raportit të Analizës Vjetore të Punës për vitin akademik 2024-2025 të Universitetit të Arteve, mbështetur në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, ngrihet grupi i punës si më poshtë:
 - Prof. Dr. Erald Bakalli Kryetar
 - Prof. Asoc. Dorian Çene Anëtar
 - Prof. Arian Paço Anëtar
 - Prof. Arben Llozi Anëtar
 - Prof. Miltiadh Kutali Anëtar
 - Prof. Sadik Spahija Anëtar
 - Znj. Alma Sinanaj Anëtare
7. Raporti i Analizës Vjetore i Universitetit të Arteve, i përgatitur nga grupi i punës, sipas pikës 5 të këtij urdhri, të përfundohet **brenda datës 17.12.2025**.
8. Ky urdhër të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve, në rubrikën “Njoftime” si dhe t’u shpërndahet të gjithë instancave dhe strukturave të Universitetit të Arteve.
9. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, të gjitha njësitë kryesore, njësitë bazë, drejtoritë, degët/sectorët, strukturat si dhe anëtarët e grupit të punës sipas pikës 5 të këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Erald Bakalli

